Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e autorizimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Gjemajli Bellanica	**20.03.2023**	**31.03.2023**	**2023/0146**

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 17.03.2023, OE "ALB - Architect SH.P.K."- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2023/0146, kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku është rekomanduar për kontratë OE "Gjeokonsult&CO" & "ENG Idea sh.p.k" & "SIB BKA sh.p.k", lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Sherbime profesionale inxhinierie per nevoja te MPB-se - ritender" me nr. të prokurimit: "214-22-2267-2-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbim, vlera e parashikuar e kontratës: 333.000.00 €. Vendimet e mëparshme lidhur me këtë lëndë janë: Vendimi nr.Nëse është e përsëritur ankesa, të shënohet se lidhur me këtë lëndë është nxjerr një vendim i mëparshëm i OSHP-së, më Nr. 679/22-704/22 i datës 09.02.2023.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

Njoftimit për Kontratë.....04.04.2022

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve 13.05.2022

Sqarimet e fundit nga AK 13.05.2022

Hapje e Ofertave:.....26.05.2022

B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.....04.07.2022

Kërkesa për Rishqyrtim.....19.07.2022

Ankesat e parashtruar në OSHP.....21.08.2022

Vendimi i OSHP- së nr. 285/22.....12.09.2022

B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues.....09.11.2022

Kërkesa për Rishqyrtim.....12.11.2022

Vendimi i AK-së në lidhje me kërkesat për Rishqyrtim.....18.11.2022

Ankesat e parashtruar në OSHP.....19 dhe 25.11.2022

Vendimi mbi pezullimin e aktivitetit të Prokurimit nga AK.....21.11.2022

Vendimi i OSHP- së nr.679/22-704/22.....09.02.2023

Kërkesa për Rishqyrtim.....03.03.2023

Njoftimi mbi vendimin e AK-së 28.02.2023

Vendimi i AK-së lidhur me kërkesën për Rishqyrtim.....08.03.2023

Ankesa është e përsëritur.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim / Jo – Diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe krahasimi i tendereve

Neni 69 Aftësit teknike dhe/ose profesionale

Ligji i Punes i R. se Kosovës 03/L-212

Ligji nr. 7703; 8889;104, Për Sigurimet shoqërore në R e Shqipërisë

OE Alb-Architect Sh.P.K pretendon se AK i ka shkelur këto dispozit
042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I r
Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092)

Neni 7

Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyr
diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Kjo dësl
favorizoj respektivisht ta trajtoj ofertën e këtij grupi ne mënyrë jo
është dorëzuar dhe plotësuar dosja e tenderit ashtu si është kërkua
ku theksohet paraqitja e kërkesave mbi mundësit teknike dhe / o

Neni 59

Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tende

Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjs
në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtrua
kontratës dhe në dosjen e tenderit. Ne rastin konkret AK nuk ka v
legjislacionit ne fuqi për trajtimin e plotësimit te kriterit me nr 1.5
16 te dosjes se tenderit

Neni 69

Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale

Pakënaqësitë apo ta quaj kundërligjshmëritë me rastin e shpalljes

nr i prokurimit **214-22-2267-2-1-1** titulluar **Shërbime profe**
nevoja të MPB-së - ritender nga AK , OE - Gjeokonsult & C
SIB-Bka sh.p.k i cili ka parapare si staf lidhur me ekzekutimin e
AK **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME** me titull
inxhinierie për nevoja të MPB-së - ritender personat te
legjislacionin ne fuqi te Republike se Kosovës.
OE - Gjeokonsult & Co & ENG Idea Sh.p.k & SIB-Bka sh.p.k k
profesional punëtoret e vet si përgjegjëse për pozicionet e përcal
dosjes se tenderit ne Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (
9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale respekt
ne projektin e tenderuar nga AK **MINISTRIA E PUNËVE TË**
Shërbime profesionale inxhinierie për nevoja të MPB-së - rite
Përcaktimi i këtyre punëtorëve te cilët e kane mbushur mos
pozicionet e personelit kyq te projektit apo te pozicioneve tjera
dhe angazhim permanent ne projekt është ne kundërshtim me
PUNËS se Kosovës.
Me nenin 2 te këtij LIGJIN Nr. 03/L-212 E PUNËS është theks
ligji zbatohen për të punësuarit dhe punëdhënësit e sektori
Republikën e Kosovës.
Ne nenin 3 te këtij LIGJIN Nr. 03/L-212 E PUNËS janë parap
cilat sqarohen termet Marrëdhënie pune dhe Kontrate pune , dhe
1.10. Marrëdhënia e Punës - një marrëveshje ose rregullim
punëdhënësi dhe të punësuarit për kryerjen e detyrave dhe përg
punësuari nën mbikëqyrjen e punëdhënësit, kundrejt një pagese t
formë të parave;
1.11. Kontrata e Punës - akti individual e cila lidhet ndërm
punësuarit, me të cilën rregullohen të drejtat, detyrat dhe përg
marrëdhënia e punës në pajtim me këtë ligj, me Kontratën K
Brendshëm të Punëdhënësit;

Nga kjo munde te shihet se as një OE nuk mund te emëroj -
projektit apo ndonjë pozicion tjetër ne kuadër te projektit pa e kri
e punës dhe kontratën e punës me atë person. Me nenin 7 dhe
është e trajtuar krijimi i marrëdhënies se punës dhe te kontratës se
Me nenin 67 te këtij LIGJIN Nr. 03/L-212 E PUNËS ësh
Kontratës së Punës sipas fuqisë ligjore qe nënkupton se çdo in
privat apo publik duke përfshi edhe OE ne fjale është dashtë ta re
Ky nen e thekson se Kontrata e Punës sipas fuqisë ligjore, ndërpr
1.1. me vdekjen e të punësuarit;
1.2. me vdekjen e punëdhënësit, kur puna e kryer apo shërbime
janë të natyrës personale, atëherë kur kontrata nuk mund të vaz
punëdhënësit;
1.3. me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës;
1.4. kur i punësuari e mbush moshën e pensionimit, prej gj
vjeç;
1.5. në ditën e dorëzimit të aktvendimit të plotfuqishëm për
aftësive për punë;
1.6. nëse i punësuari shkon në vuajtje të dënimit i cili do të zgjas
muaj;
1.7. me vendimin e gjykatës kompetente, vendim që pason ndërp
punës;
1.8. me falimentimin dhe likuidimin e ndërmarrjes; 1.9. rastet e
ligjeve në fuqi.

Sipas paragrafit te 1.4 te këtij neni as një person fizik qe pensionimit nuk mund te emërohet si si personel kuq i projel marrëdhënie te rregullt pune.

Nëse behet një analize ligjore edhe ne vendin ku jeton dhe vepro personat ne fjale janë te pensionuar respektivisht nuk mund te kë pune. Sipas LIGJ Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet sh Shqipërisë", të ndryshuar nenit 92 ku trajtohet - Zgjatja graduale së sigurimit për pension (Ndryshuar neni me Ligjin nr. 8889, ndryshuar neni me Ligjin nr. 104/2014, datë 31.07.2014, neni 43 e sigurimit për pension pleqërie, deri në arritjen e moshës dhe p sigurimit, që përcaktohet në pikën 1, të nenit 31, të këtij Ligji, d që vijojnë: **MOSHA DHE PERIUDHA E SIGURIMIT VITE PËR SECILËN KATEGORI**

Burri	Kategoria I		Kategoria II	
Vitet	Mosha	Vjetërsia e punës	Mosha	Vje pun
01.07.2005 - 30.06.2006	56	26	61v	35
01.07.2006 - 30.06.2007	56	27	61v 6m	35
01.07.2007 - 30.06.2008	57	28	62v	35

Me rastin e prezantimit te listës se stafit Profesional te dorëzuar n
Co & ENG Idea Sh.p.k & SIB-Bka sh.p.k sipas kërkesave ne FD
Gjeokonsult & Co & ENG Idea Sh.p.k & SIB-Bka sh.p.k ka dorë
dy persona qe kane moshën mbi 72 respektivisht 80 vjeçare respe
pensionuar dhe ata janë :
1.5 Vyrtyt Llanaj, me profesion Ing. Hidroteknik i ngarkuar me p
Ing.Projektues/Mbikeqyres (**82 vjeç**) ;
1.7 Haseni Kadareja, me profesion Ing. Elektrik i ngarkuar me p
Ing.Projektues/Mbikeqyres (**73 vjeç**) .

Nëse i referohemi dispozitave ligjore te lartcekura dhe Interpretin
Udhëheqëse e Departamentit Ligjore MPMS (qe është pjese përb
shihet se këta persona nuk munden te jene staf i rregullt profesion
edhe nuk mundet te konsiderohet OE - Gjeokonsult & Co & ENG
sh.p.k i përgjegjshëm ne plotësimin e kritereve te parapara me Se
Dhënave të Tenderit (FDT) respektivisht 9.1 & 9.2 Kërkesat mbi
dhe/ose profesionale, te parapare me dosjen e tenderit nr. prokuri
titulluar **Shërbime profesionale inxhinierie për nevoja të MPB**
Gjithashtu vlen te theksohet se edhe Arian Coka, ne Cv e tij nuk
cili është mbikëqyrë apo është ekzekutuar qe është i **fushës se en**
ashtu si është kërkuar me Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tende
9.1 & 9.2 Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale n
thekson si ne vijim : **1.10 Ekspert për energji eficiente - inxhin**
master në drejtim teknik (të gjitha drejtimet në Fakultet Tek
përvojë pune, min 1 projekt në detyrën e elaborateve për ene
kërkesë mund të mbulohet me cilindo inxhinier nga stafi i kër
Vlen te theksohet se referenca për ndonjë pune te kryer duhet te j

eksperiencën e ushtrimit te profesionit qe eshte e pasqyruar ne CV
Arian Coka. Mos korrespodenca me CV dhe elementet tjera vu ne
objektivitetin e referencës e cila nuk e tregon fushën përkatëse te
tenderit andaj ne e konsideronim si te pa plotësuar këtë kriter me
E drejta ne pune konsiderohet si e drejt fondamentale dhe ë
dispozitat e Kushtetutës se Kosovës por edhe te Akteve ndërk
nenin 22 te Kushtetutës se Kosovës, ku e drejta e pensionimit ka
kuadër te këtyre akteve juridike.
Andaj duke i pasur parasysh këto shkelje - lëshime ligjore te AK
te tenderit te OE - Gjeokonsult & Co & ENG Idea Sh.p.k & SIB-
qe AK ta konsideroj si jo te përgjegjshëm këtë OE - Gjeokon
Sh.p.k & SIB-Bka sh.p.k sipas nenit 69 te LPP dhe ta anulo
tenderimin e tij.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendin tuaj të themelimit me informata mbi biznesin dhe veprimtaritë. Për Operatorin Ekonomik jo rezident në Kosovë, nëse shpërblehet me kontratë, para nënshkrimit të kontratës, është i obliguar që ta regjistrojë përfaqësinë e biznesit në Republikën e Kosovës.

b. Deklarues i TVSH-së, (për kompanitë vendore).

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme Autoritetit kontraktues se qarkullimi vjetor i OE gjatë periudhës (nga Njoftim për Kontratë për periudhën e shkuar trevjeçare) ka qenë prej jo më pak se 500,000.00 euro. Në rast të pjesëmarrjes së grupit të OE, lideri i grupit duhet të përmbushë së paku 60% të këtij qarkullimi minimal.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1.1 Menaxheri i projektimit - inxhinier i diplomuar apo master i arkitekturës ose inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë, drejtimi - konstruktiv - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit në detyrën e menaxherit të projektimit, min. 2 projekte në fushën e projektimit në ndërtim të lartë.

1.2 Menaxheri i mbikëqyrjes inxhinier i diplomuar apo master i arkitekturës ose inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë, drejtimi - konstruktiv - min. 5 vjet përvojë pune pas diplomimit, min. 2 projekte në detyrën e mbikëqyrësit në ndërtim të lartë.

1.3 Minimum dy inxhinierë të diplomuar ose master të arkitekturës -min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, në detyrën e arkitektit, min 2 projekte në projektim të objekteve.

1.4 Minimum dy inxhinierë të diplomuar ose master të ndërtimtarisë-drejtimi konstruktiv - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min 2 projekte në detyrën e projektuesit të konstruksioneve ndërtimore.

1.5 Një inxhinier të diplomuar ose master të ndërtimtarisë-drejtimi hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min. 1 projekt në detyrën e projektuesit dhe min. 1 projekt në detyrën e mbikëqyrësit të hidro instalimeve.

1.6 Inxhinier i diplomuar ose master i elektroteknikës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min 1 projekt në detyrën e projektuesit dhe min. 1 projekt në detyrën e mbikëqyrësit të instalimeve elektrike - tensioni i ulët.

1.7 Inxhinier i diplomuar ose master i energjetikës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min. 1 projekt në detyrën e projektuesit dhe min. 1 projekt në detyrën e mbikëqyrësit të instalimeve elektrike - tensioni i lartë.

1.8 Inxhinier i diplomuar ose master i makinerisë - drejtimi termo-energjetik- min.3 vjet përvojëpune pas diplomimit, min. 1 projekt në detyrën e projektuesit dhe min. 1 projekt në detyrën e mbikëqyrësit të instalimeve makinerike.

1.9Inxhinier i diplomuar ose master i gjeodezisë - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min 2 projekte në detyrën e matjeve gjeodezike.

1.10 Ekspert për energji eflciente - inxhinier i diplomuar ose master në drejtim teknik (të gjitha drejtimet në Fakultet Teknik) - min. 2 vjet përvojë pune, min 1 projekt në detyrën e elaborateve për energji eficiente. Kjo kërkesë mund të mbulohet me cilindo inxhinier nga stafi i kërkuar në pozitat tjera.

1.11 Një (1) Inxhinier ose bachelor në menaxhimin e emergjencave – min. 2 vjet përvojë pune pas diplomimit, min 1 projekt në detyrën e elaborateve kundër zjarrit.

2.1 OE duhet të dëshmojë së është i certifikuar me ISO 9001 valide.

2.2 OE duhet të dëshmojë se është i certifikuar me ISO 27001 valide.

2.3. OE duhet të dëshmojë se është i certifikuar me ISO 10002 valide.

3.1Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte në fushën e projektimit (objekte administrative, renovime të objekteve administrative, objekteve të sigurisë së lartë (policore, ushtarake, inteligjencës ose kufitare të nivelit qendror), etj. në vlerë prej të gjitha së bashku jo më pak se 350,000.00 €uro.

3.2Operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomikë duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses mbikëqyrje të punimeve të ndërtimit të lartë dhe të ulët, në vlerë prej të gjitha së bashku jo më të vogël se 100,000.00€.

Dëshmitë e kërkuara dokumentare të përshtatshmërisë profesionale

a. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, me informata dhe veprimtaritë e biznesit (kopje).

b. Certifikata e TVSH-së (kopje).

Dëshmitë e kërkuara dokumentare mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

1. Deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore ose nga vendi i origjinës për tri vjetët e fundit (2019, 2020, 2021) - kopje.

Dëshmitë e kërkuara mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

1.1Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt, vendimi për menaxher të projekteve i nënshkruar dhe vulosur - (origjinal). Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.2 Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt, vendimi për menaxher të mbikëqyrjes i nënshkruar dhe vulosur - (origjinal). Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.3Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.4Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.5Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo

dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.6Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.7Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.8Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.9Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.10Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

1.11Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëminë e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje);

2.1 Certifikata profesionale ISO 9001 ((kopje e noterizuar nga origjinali)

2.2 Certifikata profesionale ISO 27001 (kopje e noterizuar nga origjinali)

2.3 Certifikata profesionale ISO 10002 (kopje e noterizuar nga origjinali)

3.1. Lista e kontratave të përfunduara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projektet e realizuara. Plotësimi, nënshkrimi dhe vulosja e Aneksit nr. 6 të dosjes së tenderit, (origjinal), duke bashkëngjitur referenca (kopje) ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve (kopje) duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit.

3.2. Lista e kontratave të përfunduara - origjinal e vulosur dhe e nënshkruar nga OE për projektet e realizuara. Plotësimi, nënshkrimi dhe vulosja e Aneksit nr. 6 të dosjes së tenderit, (origjinal), duke bashkëngjitur referenca (kopje) ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të projekteve (kopje) duke treguar vlerën, datën dhe vendin e realizimit.

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

Ministria e Punëve të Brendshme bazuar në vendimin e OSHP-së nr 285/22 i dates 12.09.2022, shpërblen me kontratë operatorin ekonomik **Grup i OE "GJEOKONSULT&CO"; "ENG IDEA" SH.P.K.; "SIB-BKA" SH.P.K - Mbikalimi Kamëz -Tiranë** në vlerë totale të ofertës në shumë prej **233,061.80 Euro.**

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

OE ankues nuk kualifikohet si palë me interes sipas Nenit 4.1.26 të LPP-së

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

679/22-704/22

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **ALB - Architect SH.P.K.**

<u>Përgjigje ne Pretendimet ankimore 1</u>

Përmbledhje ne pike te shkurtër e pretendimit ankimor.

OE ankues pretendon se OE i rekomanduar per kontrate ne listën e stafit te tij ka ofruar dy persona mbi moshën 72 vjeç respektivisht 82 vjeç, këta persona nuk mund te jene staf i rregullt i kompanis dhe do te duhej te shpallej i pa përgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: Kërkesa për inxhinier te Hidroteknikes "*Një inxhinier të diplomuar ose master të ndërtimtarisë-drejtimi hidroteknik - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min. 1 projekt në detyrën e projektuesit dhe min. 1 projekt në detyrën e mbikëqyrësit të hidro instalimeve*".

Kërkesa për inxhinier elektrik "*Inxhinier i diplomuar ose master i energjetikës - min. 3 vjet përvojë pune pas diplomimit, min. 1 projekt në detyrën e projektuesit dhe min. 1 projekt në detyrën e mbikëqyrësit të instalimeve elektrike - tensioni i lartë* ".

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: Dëshmitë për inxhinier hidroteknik

"*Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëmine e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje)*";

Dëshmia për inxhinier Elektrik; "*Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëmine e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje)*"

Pas analizimit të dokumentacionit të ofruar në E prokurim për këtë aktivitet të prokurimit, Eksperti Shqyrtues sqaron se për plotësimin e kërkesave të dosjes së tenderit të lartcekura, OE i rekomanduar për kontratë për Inxhinier të Hidroteknikes ka ofruar z. Vyrtyt Llanaj 72 Vjeçar,ndërsa për inxhinier elektrik ka ofruar z. Haseni Kadareja 82 Vjeçar.

Për z. Llanaj janë ofruar këto dëshmi si në vijim : Licencë, Vërtetim i diplomës tek noteri, Diplomë, kontratë pune, CV-ja, një dokument i emërtuar Lista e kontributeve te Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe te ardhurat nga punësimi, Referencë.

Për z. Kadare janë ofruar këto dëshmi si në vijim: Licencë, Vërtetim i diplomës, Diplomë, CV-ja, kontratë e punës, një dokument i emërtuar Lista e kontributeve te Sigurimeve Shoqërore, shëndetësore dhe te ardhurat nga punësimi, Referencë.

Eksperti Shqyrtues, sqaron se për këta inxhinier është ofruar kontrata e punës në të cilën theksohet vlefshmëria juridike 5 vjeçare, po ashtu në kontratë të punës për inxhinieret evidentohet se koha e punës së inxhinierëve është theksuar nga ora 8:30 deri 17:00 nga e Hëna në të premte, ndërsa të Shtunën nga ora 8:30 deri 14:30, nga kjo shihet se inxhinierët kanë kontratë me kohë të rregullt me OE të rekomanduar për kontratë, dhe kjo bie ndesh me Nenin 67 të Ligjit të punës së Kosovës, si dhe me nenin 92 të Ligjit për Sigurime shoqërore në Republikën e Shqipërisë, për faktin se kur personi mbush moshën 65 vjeç ai gëzon pensionin qoftë kontribut dhënës apo edhe atë me arritjen e moshës, nuk mund të jetë i punësuar me orar të plotë ngase edhe periudha e kontributeve pensionale përfundon në moshën 65 vjeçare, konsideroj se inxhinierët mbi moshën 65 vjeçare mund të angazhohen si konsulent etj, por jo si staf i rregullt profesional. Andaj pretendimi i OE ankues është i bazuar për faktin se dy inxhinierët e lartcekur kanë moshën mbi 65 vjeç, më saktësisht 72 dhe 82 vjeç.

<u>Përgjigje ne Pretendimet ankimore 2</u>

Përmbledhje ne pike te shkurtër e pretendimit ankimor.

Gjithashtu vlen të theksohet se edhe Arian Çoka në CV e tij nuk posedon asnjë projekt i cili është mbikëqyrës apo është ekzekutuar që është i fushës së energjisë efiçiente ashtu siç është kërkuar në nenin 9.1&9.2 në pikën 1.10.

Eksperti Shqyrtues, konstaton që kërkesë e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë është: "*Ekspert për energji eficiente - inxhinier i diplomuar ose master në drejtim teknik (të gjitha drejtimet në Fakultet Teknik) - min. 2 vjet përvojë pune, min 1 projekt në detyrën e elaborateve për energji eficiente. Kjo kërkesë mund të mbulohet me cilindo inxhinier nga stafi i kërkuar në pozitat tjera"*.

Ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar: "*Diploma përkatëse e noterizuar nga origjinali, CV, kontrata ose marrëveshja e punës valide për këtë projekt. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon për punët dhe përvojën e mëparshme në lëmine e kërkuar. Letër reference nga punëdhënësit ose çfarëdo dokumenti tjetër që dëshmon projektet e realizuara – (kopje)*".

Lidhur me plotësimin e kësaj kërkese të dosjes së tenderit ekspert për energji efiçiente, OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar inxhinierin elektrik z. Arjan Çoka, ku në CV e ofruar nga inxhinieri nuk ka ndonjë projekt të listuar në CV që i njëjti ka *projekt në detyrën e elaborateve për energji eficiente*. Rrjedhimisht pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Autoriteti Kontraktues, në këtë aktivitet të prokurimit nuk ka respektuar në tërsi dispozitat e Nenit 7 dhe 59 të LPP-së.

Përfundim,

Eksperti Shqyrtues, duke u mbështetur në Nenin 43.5 pika b "*asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm*" i Rregullores për Prokurim Publik, rekomandon të anulohet aktiviteti i prokurimit me titull: "Shërbime profesionale për nevoja të MPB-së" dhe nëse më tutje AK ka interes mund ta inicioj përsëri.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar, ndërsa AK ta anulojë aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – **ALB - Architect SH.P.K.**

Gjemajli Bellanica